

Thirrja nga data 04.12.2024 deri në datën 10.12.2024

**TERMAT E REFERENCESPËR
OFRIMI I SHËRBIMEVE HOTELIERE PËR ZHVILLIMIN E PUNËTORIS DY DITORE
NGA OJQ "NEVO KONEPTI"**

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI"
Objektiva	Ofrimi i shërbimeve hoteliere për ushqim, akomodim dhe sallën e trajnimeve.

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët përshumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj."

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synimthelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

OJQ Nevo Koncepti nga tetori 2023, ka filluar të zbatojë projektin "Fuqizimi i komuniteteve të cenueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës" në Komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

Projekti është i shtritur në dymbëdhjet shkolla në tre komunat e cekura më lartë, nga ky numër në gjashtë shkolla fillore të mesme të ulta dhe gjashtë shkolla të mesme të larta profesionale. Kryesisht aktivitetet e projektit janë në lidhje me fuqizimin e nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në vazhdimsin e shkollimit, orjentim në karrierë dhe përgaditje e qëndrueshmërisë në tregun e punës.

"Fuqizimi i komuniteteve të cenueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës" është projekt tre vjeçarë i cili implementohet nga OJQ "Nevo Koncepti" në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe ka si qëllim kryesor fuqizimin e vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë duke u ofruar atyre njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për një tranzicion të suksesshëm në moshën madhore dhe punë dinjitoze dhe të qëndrueshme.

2. OBJEKTIVA

Nevo Koncepti është në kërkim të një (1) hoteli që ofron shërbime dhe kushte të përshtatshme për zhvillim të punëtorisë.

3. KUSHTET QË DUHET TË PLOTSOHEN

- Sallë e mjaftueshme për të akomoduar rreth njëmbëdhjet (11) pjesëmarrës në mënyrë komode.
- Pajisje teknike: projektor apo ekran, dhe internet i shpejtë dhe i qëndrueshëm.
- Dhoma me kushte standarde (ngrohje/ftohje, tualet privat, dhe Wi-Fi).
- Ofrimi i vakteve të rregullta (mëngjes, drekë dhe darkë), duke përfshirë opsione dietike të ndryshme (vegan, pa gluten, etj.).
- Shërbime për pushimet e shkurtra me kafe (kafe, çaj, ujë, fruta dhe ëmbëlsira të lehta).
- Parkim i sigurt dhe i mjaftueshëm për ata që udhëtojnë me vetura.

4. REZULTATET E PRITSHME

Përgjatë kohës së publikimit të kësaj thirrje presim aplikime serioze dhe të përshtatshme për përzgjedhjen e një Hoteli duke na ofruar oferën si më poshtë:

Ofertë akomodimi për një natë për person, ushqim për dy vakte dreke dhe një darkë si dhe ofrimin e sallës së trajnimeve/punëtorive.

5. AFATI KOHORË I ZHVILLIMIT TË PUNËTORIS

Puntoria do të fillojë sipas këtyre datave:

- 12-13 Dhjetor 2024

6. INFORMACIONE PËR PAGESËN

Nevo Koncepti për shërbimet hoteliere të ofruara, do të paguajë faturën e lëshuar bazuar në ofertën e ofruar, përmes transferit bankar. brenda afatit kohor prej shtatë ditësh.

7. PROCEDURAT E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) Ofertën duke specifikuar ofertimin e këtyre kërkesave: njëmbëdhjet dhoma njeshe, sallë për takime për dy ditë të plota, drekë për njëmbëdhjet persona dy ditë, darkë për njëmbëdhjet persona një natë, ujë për njëmbëdhjet persona gjatë trajnimit dy herë në ditë për dy ditë, kafe pauza për njëmbëdhjet persona dy herë për dy ditë.
- b) Certifikatën e ARBK-s

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 10.12.2024** në m.elshani@nevokoncepti.org / elshanimuhamed@gmail.com duke e kopjuar (cc) në email o.osmani@nevokonepti.org